

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



ZGJEDHJE PRESIDENCIALE 2014

DORACAK PËR EDUKIMIN E ANËTARËVE
TË KËSHILLAVE ZGJEDHOR PËR VOTIM JASHTË VENDIT
NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE-KONSULLORE
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
- PËRKATËSISHT NË ZYRAT KONSULLORE



MESAZHI I KOMISIONIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Të nderuar anëtar të Këshillave Zgjedhor,

Vetëm zgjedhjet të cilat kanë kredibilitet dhe i respektojnë parimet e demokracisë dhe qeverisjes së mirë, kontribuojnë në zhvillimin demokratik të shoqërisë. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, me zbatimin e suksesshëm të zgjedhjeve vendos fondamentin e demokracisë dhe kontribuon në zhvillimin dhe mirëbesimin e sistemit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në mënyrë kontinuele përpiket të shfaq shembull dhe të mbajë reputacion si organ zgjedhor i pavarur, i paanshëm dhe me përgjegjësi.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në çdo rast është i përgatitur që të realizoj zgjedhje të cilat janë në përputhje me normat demokratike ndërkombëtare, gjatë asaj i përcaktuar për ndjekjen e principit të ciklit zgjedhor. Një nga hallkat më kryesore në zinxhirin e realizimit të këtyre qëllimeve është edhe Këshilli Zgjedhor. Si anëtar të tyre pikërisht jeni ju ata të cilët mbani pjesë të barrës, përgjegjësisë por edhe meritat dhe nderin për realizim të suksesshëm të zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, pritjet nga Ju janë të larta, por mirënjohja për realizimin e tyre është akoma edhe më e lartë.

Pjesëmarrja e përbashkët në procesin e bartjes së nivelit të lartë të demokracisë, është vlerë e çmuar.

Edhe njëherë do ta verifikojmë dhe do ta përforcojmë rolin tonë, në shoqërinë demokratike të Republikës së Maqedonisë, duke siguruar kushte të barabarta të zgjedhjeve, për të gjithë pjesëmarrësit liri dhe fshehtësi të njëjtë të votës për secilin zgjedhës.

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

KRYETAR

Nikola Rilkoski



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
KËSHILLI ZGJEDHOR NË PDK.....	5
ZGJEDHJA DHE PËRBËRJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR.....	5
PUNA DHE VENDIMARRJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR.....	6
SI TË GJENI DHE TË PËRDORNI RREGULLATIVËN ZGJEDHORE.....	6
AKTIVITETET E KËSHILLIT ZGJEDHOR.....	7
DITA PARA ZGJEDHJEVE.....	8
MBLEDHJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE.....	8
RREGULLIM I VENDVOTIMIT.....	8
DETYRAT E KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR.....	9
DITA E ZGJEDHJEVE.....	12
PRANIMI DHE SIGURIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR.....	12
LLOJET E MATERIALIT ZGJEDHOR.....	13
PËRGATITJE PARA FILLIMIT TË VOTIMIT.....	14
ARRITJE NË VENDVOTIM.....	14
PËRGATITJE TË FUNDIT PARA FILLIMIT TË VOTIMIT.....	15
PARA SE TË VOTOJË VOTUESI I PARË.....	15
PERSONAT QË MUND TË JENË TË PRANISHËM NË VENDVOTIM.....	15
PËRFAQËSUES TË AUTORIZUAR TË PARASHTRUESVE TË LISTAVE TË KANDIDATËVE.....	16
VËZHgues TË AKREDITUAR.....	16
GAZETARË.....	16
VOTIMI.....	17
KOHËZGJATJA E VOTIMIT.....	17
E DREJTA E VOTIMIT.....	17
GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE PËR DALJEN E VOTUESVE.....	17
PROCEDURA E VOTIMIT.....	18
ANKESA NGA ZGJEDHËSIT.....	21
VOTIMI I PERSONAVE QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË.....	21
MBYLLJE E VENDVOTIMIT.....	21
NDËRPRERJE E VOTIMIT.....	23
SUMIMI DHE VERIFIKIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE TË VENDVOTIMIT.....	23
PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR.....	28
NDALËSAT NË VENDVOTIM.....	30
NDALIMI I PËRDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR	
DHE FOTOAPARATIT PËR FOTOGRAFIMIN E FLETËVOTIMIT.....	30
NDALIM PËR MBAJTJEN E ARMËS NË VENDVOTIM.....	30
NDALIMI I VOTIMIT FAMILJAR, GRUPOR DHE NË EMËR TË TJETRIT.....	30
DALLIMI MIDIS VOTIMIT FAMILJAR DHE NË GRUP, SI DHE VOTIMIT PËR PERSON TJETËR	
DHE VOTIMIT TË PERSONAVE QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË.....	32
BASHKËPUNIMI ME POLICINË NË DITËN E ZGJEDHJEVE.....	32



HYRJE

Në Republikën e Maqedonisë organet zgjedhore përbëhen nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisionet Komunale të Zgjedhjeve, Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, Këshillat Zgjedhor dhe Këshillat Zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve në Përfaqësitë diplomatike-konsullore, përkatësisht, në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit. Roli i tyre është të sigurojnë zgjedhje të drejta, të lira dhe demokratike. Organet zgjedhore duhet të sigurojnë që çdo qytetar të votojë në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë, me të drejtë vote të barabartë. Një votues = një votë.

Përgjegjësinë më të madhe në këtë proces, e kanë këshillat zgjedhor që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe nga puna e tyre varet cilësia e zgjedhjeve. Këshillat Zgjedhor gjithashtu kanë detyrë dhe përgjegjësi për realizimin e kompetencave të tyre.

Për të siguruar besimin e qytetarëve në rezultatet zgjedhore, zgjedhjet vëzhgohen nga vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve dhe mediet. Ata gjithashtu, sigurojnë transparencën dhe legjitimitetin e zgjedhjeve. Për shkak të kësaj, rëndësi të veçantë ka bashkëpunimi i Këshillit Zgjedhor me të gjitha palët në procesin zgjedhor.

Detyra kryesore është zbatimi i plotë i procedurave zgjedhore. Për t'i zbatuar detyrat, organet zgjedhore duhet të njohin dhe t'i përcjellin procedurat e përcaktuara të Kodit zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëse nuk zbatoni procedurat e përcaktuara, ekzistojnë ndëshkime përkatëse duke filluar nga largimin nga organi zgjedhor, gjoba dhe dënime me burg për vepra të rënda kundër zgjedhjeve.

Votimi i diasporës do të zbatohet në përfaqësitë diplomatike-konsullore dhe në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit, ku është definuar në nenin 113 të Kodit zgjedhor. Përfaqësitë konsullore-diplomatike përkatësisht zyrat konsullore në ditën e zgjedhjeve do të shërbejnë si vende të votimit. Votimin në diasporë e zbatojnë këshillat zgjedhor të veçanta (KZ-PDK). Votimi mbahet një ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë, duke pasur kujdes në llogaritjen e diferencën kohore në vendit.

Transportimin dhe vendosjen e anëtarëve të KZ-së në vendet ku zbatohet votimi, e organizon Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Gjatë qëndrimit të anëtarëve të KZ-së në vendin ku zbatohet votimi, personi i punësuar në PDK, do të sigurojë përkrahje logjistike.



KËSHILLI ZGJEDHOR NË PDK

Këshilli Zgjedhor është organ që kujdeset për zbatimin e ligjshëm të zgjedhjeve, i cili drejtpërdrejt i zbaton zgjedhjet në vendvotim.

Si anëtar i keshillit Zgjedhor, Ju jeni një nga përfaqësuesit e administratës zgjedhore, me të cilën zgjedhësit gjatë votimit do kenë kontakt të drejtpërdrejt me Ju. Ju jeni pasqyra e zgjedhjeve në sytë e publikut vendas dhe atij ndërkombëtar.

Për këtë arsye, gjatë zbatimit të zgjedhjeve duhet të dëshmoni nivel të lartë të profesionalizmit dhe të integritetit në punën tuaj. Kjo ka të bëjë me detyrat tuaja para ditës së zgjedhjeve (p.sh. prani në trajnimin e detyrueshëm që e organizon Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve), detyrimet dhe përgjegjësitë në ditën e votimit, si dhe numërimit të votave pas përfundimit të votimit.

Angazhimi juaj duhet të sigurojë fshehtësinë e votimit por edhe saktësinë, integritetin, sigurinë, transparencën dhe zhvillimin e qetë të procesit zgjedhor, me një fjalë të kontribuoni në mbajtjen e nivelit të lartë në mirëbesimin e procesit zgjedhor.

ZGJEDHJA DHE PËRBËRJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR


Këshilli Zgjedhor formohet për secilin vendvotim. Këshillat Zgjedhor për votim në diasporë janë të definuar me Vendim të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili mund të gjendet në ueb faqen e KSHZ-së.

Këshilli Zgjedhor përbëhet prej kryetari, zëvendëskryetarit, katër anëtarëve dhe zëvendësve të tyre. Kryetari i Keshillit Zgjedhor zgjidhet nga radhët e diplomatëve, të punësuar në PDK-në përkatëse, ndërsa zëvendëskryetari, dy anëtarë dhe dy zëvendës-anëtarë zgjidhen me zgjedhje të rastit me mandatë 4 vjeçar nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike komunale dhe në administratën e qytetit të Shkupit.

Anëtarët dhe zëvendës-anëtarët tjerë zgjidhen me propozim të partive politike të mazhorancës dhe të opozitës, të cilët në zgjedhjet e fundit për deputet kanë fituar më shumë vota.

Partitë politike për çdo cikël zgjedhor, për anëtarë dhe zëvendës-anëtarë të Këshillave Zgjedhor dorëzojnë propozime të reja.

Personi i zgjedhur për kryetar, anëtar ose zëvendës-anëtar të Keshillit Zgjedhor ka të drejtë që të mos pranojë të kryejë këtë detyrë, vetëm për shkaqe shëndetësore ose familjare. Për mospranimin e detyrës vendos KSHZ-ja në bazë të dokumentacionit të ofruar përkatës.



PUNA DHE VENDIMARRJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR

Këshilli Zgjedhor vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Në mungesë të ndonjë anëtar, në punën e Këshillit Zgjedhor merr pjesë zëvendësi i tij. Çdo anëtarë i Këshillit Zgjedhor dhe përfaqësuesit e autorizuar të parashtresve të listave të kandidatëve, kanë të drejtë të parashtrojnë vërejtje në procesverbal.

Gjatë zbatimit të zgjedhjeve, në punën e Këshillave Zgjedhor në njësitë zgjedhore ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, në përdorim zyrtar është edhe gjuha dhe alfabeti i përdorur nga të paktën 20% e qytetarëve në atë njësi zgjedhore.

SI TË GJENI DHE TË PËRDORNI RREGULLATIVËN ZGJEDHORE

Këshilli Zgjedhor kryen detyrat në suazat e kompetencave të tij, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Rregulloret, udhëzimet dhe formularët janë në dispozicion në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve: www.sec.mk

Kur KZ-ja, nuk është e sigurt si të veprojë gjatë kryerjes së ndonjë veprimi zgjedhor, duhet të konsultohet me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.



AKTIVITETET E KËSHILLIT ZGJEDHOR

Aktivitetet e Këshillit Zgjedhor, në varësi të periudhës në të cilën ndërmerren, mund të ndahen në disa grupe:

1. NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE

- Mbledhja e KZ-së ditën para zgjedhjeve
- Rregullimi i vendvotimit

2. NË DITËN E VOTIMIT

- Përgatitje para votimit
- Votimi
- Personat që mund të jenë të pranishëm në vendin e votimit
- Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KZ-së
- Votim i zgjedhësve që kanë nevojë për ndihmë
- Mbyllja e vendvotimit
- Ndërprerje e votimit
- Mbledhja dhe verifikimi i rezultateve
- Paketimi i materialit zgjedhor dhe dorëzimi te personi i autorizuar i PDK-së

3. BALLAFAQIM ME NDALESAT NË VENDVOTIM

- Ndalim i përdorimit të pajisjeve mobile, fotoaparateve dhe mjeteve të tjera
- Votim familjar dhe votim në emër të personi tjetër
- Bashkëpunim me policinë në ditën e zgjedhjeve



DITA PARA ZGJEDHJEVE

Këshilli Zgjedhor, një ditë para ditës së zgjedhjeve ndërmerr disa veprime:

- Takohen para vendvotimit (kryetari fton Këshillin Zgjedhor në takim para vendvotimit). Kryetari dhe anëtarët bien dakord rreth ndarjes së roleve për ditën e zgjedhjeve (rekomandohet që secilit anëtar t'i jepet një listë me detyra për ditën e zgjedhjeve.
- Rregullon vendin e votimit për ditën e zgjedhjeve.

MBLEDHJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE

Këshilli Zgjedhor takohet në vendvotim dhe e rregullon vendvotimin ashtu që, ditën e nesërme të mundësohet që votimi të rrjedhë pandërprerë dhe gjatë fazës së votimit votuesve t'u mundësohet lirisht të lëvizin në lokacionin ku votohet. (Shih foto 1)

Kryetari dhe anëtarët e tjerë të Këshillit Zgjedhor bien dakord rreth ndarjes së roleve për ditën e votimit. Krahas kryetarit të KZ-së, detyrat e anëtarëve të tjerë të KZ-së janë:

- Anëtar i cili kujdeset për rendin e hyrjes në vendvotim dhe i kontrollon votuesit a kanë markim të ngjyrës së dukshme;
- Anëtar i cili kryen identifikimi e votuesve;
- Anëtar i cili shërben me ekstraktin e listës zgjedhore;
- Anëtar i cili i jep dhe i vulos fletëvotimet;
- Anëtar i cili shërben me marker-ngjyrë të dukshme për markim të votuesve, dhe i cili kujdeset që fletëvotimet të vendosen në kutinë e votimit;

REKOMANDIM: Kryetari i KZ-së secilit anëtar, varësisht nga roli që ka, duhet t'i jap një version fillestar të listës së detyrave që i ka (nga Doracaku)

Secili anëtar i KZ-së krahas detyrave kryesore që i ka, kryen edhe punë të tjera të nevojshme për zbatim të mbarë të zgjedhjeve.

RREGULLIM I VENDVOTIMIT

Këshilli Zgjedhor duhet:

- Të ngjisë shenjën me numrin e vendvotimit në hyrje të lokalit ku do votohet, të shpall listat e kandidatëve
- Të shfaq listat e kandidatëve
- Të vendos udhëzimin për votim në vend ku të gjithë që do të vijnë, të munden ta lexojnë
- Të vendosin tavolinat ose bankat në mënyrë që të lejohet realizim i papenguar i të gjitha fazave të votimit
 - Për përfaqësuesit e autorizuar dhe për vëzhguesit, duhet të sigurojë vende nga të cilat do të kenë pamje të plotë, do të mund të përcjellin nga afër verifikimin e identitetit të personit që voton dhe do të mund të vëzhgojnë procesin e votimit pa pengesë, pa cenuar parimin e fshehtësisë së votimit.
- T'i vendos paravanët e votimit në mënyrë që mos të mund të shihet, si votuesi plotëson fletën e votimit



Fotografia 1: Vendvotimi i rregulluar

DETYRAT E KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR

Kryetari i KZ-së është përgjegjës për të gjitha veprimet në vendvotim, veçanërisht për votimin dhe numërimin e votave dhe atë:

- Kujdeset për të gjitha aktivitetet që kryhen në vendvotim, në pajtim me dispozitat e Kodit zgjedhor, udhëzimet e KSHZ-së dhe procedurat e sqaruara në këtë Doracak;
- Në rast të parregullsive eventuale ose shkeljes së udhëzimit të KSHZ-së, kryetari i KZ-së këto raste i evidenton ne Ditarin për evidencë të ngjarjeve dhe e njofton Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotim;
- U jep detyra të gjithë anëtarëve të KZ-së;
- Komunikon me përfaqësuesit e autorizuar, vëzhguesit dhe gazetarët (ajo është përgjegjësi e tij)
- Për të gjitha çështjet dhe paqartësitë rreth procedurës dhe logjistikës së zbatimit të zgjedhjeve, kryetari i KZ-së konsultohet dhe është në komunikim të përhershëm me KSHZ-në.



Para fillimit të votimit

- Plotëson Procesverbalin (Formulari numë 15) për verifikimin e gjendjes së lokalit, materialit zgjedhor dhe kutitë e votimit
- Plotëson pjesën e Procesverbalit për votim, sumim dhe konfirmim të rezultateve (Formulari numër 16gs), e cila plotësohet para fillimit të votimit.
- Anëtarëve të Këshillit Zgjedhor ua shpërndan materialin zgjedhor (i besueshëm dhe jo i besueshëm).
- E shënon numrin e vendvotimit në zarf, në thasë dhe materiale tjera që do të përdoren në ditën e zgjedhjeve.
- Kujdeset (organizon) që vendvotimi të jetë i rregulluar në mënyrë përkatëse.
- Kutitë e zbrazëta ua tregojnë të gjithëve që janë të pranishëm në vendvotim.
- Mbyll kutinë e votimit me shirit siguries plastik të numëruar, dhe të njëjtën e vendos në vend të dukshëm, që të mund ta shohin të gjithë personat e autorizuar që janë të pranishëm në vendvotim. Numrat e shirit siguries plastik të numëruar i shënon në Ditar për evidencë të ngjarjeve.

Gjatë kohës së votimit

- Në procesverbal dhe në ditarin e ngjarjeve e shënon kohën e hapjes së vendvotimit (Formulari numër 16gs).
- E ndjek rrjedhën e votimit në vendvotim dhe kujdeset që ato të jenë në pajtim me procedurat e shkruara.
- Kujdeset që procesverbalet të plotësohen në mënyrë të drejtë
- Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i dorëzon të dhënat e daljes së votuesve.
- Është përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotim. Në rast të prishjes së rendit ai:
 - nëse ka nevojë të thirrret policia e njofton personin e autorizuar të PDK-së
 - plotëson Formularin në lidhje me thirrjen e policisë dhe për këtë, menjëherë e njofton Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Kur rendi dhe qetësia rivendosen kujdeset që policia ta lëshojë vendvotimin
- Evidenton në procesverbal (formulari 16a) dhe në Ditarin e evidencës së ngjarjeve, votimin e zgjedhësve të cilëve u duhet ndihma.

Gjatë kohës së mbylljes së vendvotimit

- Në ora 19:00 sipas kohës lokale të vendit përkatës, do të caktojë një anëtarë të KZ-së, i cili do të qëndrojë në fund të rendit të zgjedhësve të cilët janë hasur në objekt.
- Do ta mbyll kapakun e kutisë së votimit
- Do të vërtetohet se pas votimit të votuesit të fundit, në vendvotim janë të pranishëm vetëm personat e autorizuar
- Kohën e mbylljes së vendvotimit e shënon në Procesverbal (Formulari 16gs)
- Në ditarin për evidencë të ngjarjeve:
 - shënon kohën e mbylljes së vendvotimit
 - shënon emrat e pranishëm të përfaqësuesve të autorizuar dhe të vëzhguesve



Gjatë numërimit të votave

- Kujdeset për respektimin e procedurave të parapara, për sumimin dhe konfirmimin e rezultateve.
- Në procesverbalin (Formulari numër 16 gs) i regjistron të dhënat, të cilat janë verifikuar në procedurën e barazimit të fletëvotimeve. (Shiko: Rrafshimi i fletëvotimeve)
- Para se ta hap kutinë e votimit, i pyet përfaqësuesit e autorizuar të parashtresit të listës, nëse kanë vërejtje për procedurën e votimit, nëse kanë, vërejtjet e tyre i shënon në procesverbal (Formulari numër 16gs), në pjesën për vërejtje të procedurës së votimit.
- Kontrollon a përputhet numri i shiritave sigurues plastik të numëruar me të cilët mbyllet kutia e votimit me numrat e shënuara më parë në Ditarin për evidencë të ngjarjeve.
 - Nëse numrat përputhen, këtë e shënon në Ditar.
 - Nëse nuk përputhen, këtë rast e shënon në Procesverbal (Formulari numër 16gs), në pjesën e vërejtjeve për procedurën e votimit dhe në ditarin për evidencën e ngjarjeve, si dhe për këtë e njofton Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.
- HAP kutinë e votimit.
- Kryetari i KZ-së secilën fletë të votimit ua tregon të pranishmëve.
- Plotëson procesverbalin (formularin numër 16 gs) me rezultatet e fituara gjatë sumimit.

Gjatë kohës së paketimit të materialit zgjedhor

Kujdeset për vendosjen e materialit të tërësishëm zgjedhor në thasë përkatës. Ndjek teknikën e paketimit siç është përshkruar në pjesën e këtij doracaku „Paketimi i materialit zgjedhor”.

NË MUNGESË TË KRYETARIT TË KZ-së
AKTIVITETET E LARTPËRMENDUR I KRYEN ZËVENDËSKRYETAR



DITA E ZGJEDHJEVE

PRANIMI DHE SIGURIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

Zëvendëskryetari ose një anëtar i KZ-së nga Ministria e Punëve të Jashtme do të pranojë letër me anë të korrierit që materialin zgjedhor të paketuar, pa pengesa ta bartë deri në PDK të vendit ku do të mbahet votimi.

Materiali zgjedhor për transportim nga Republika e Maqedonisë deri në shtetin ku do të votohet, do të jetë i paketuar dhe i cilësuar si dërgesë diplomatike. Metoda e njëjtë do të zbatohet edhe gjatë kthimit të materialit zgjedhorë pas përfundimit të zgjedhjeve.

Anëtarët e këshillit zgjedhor priten nga personi i autorizuar i PDK, i cili e merr materialin zgjedhor dhe kujdeset për ruajtjen e tij në vend të sigurt të PDK-së.

- Materiali zgjedhor i dorëzohet personit të autorizuar të PDK dhe për këtë përpilohet Procesverbal
- KZ-ja materialin zgjedhor e pranon në ditën e caktuar për votim. Gjatë pranim-dorëzimit të materialit, detyrimisht duhet të jenë të pranishëm kryetari dhe anëtarë të KZ-së
- Menjëherë pas pranimi, anëtarët e KZ-së duhet hollësisht të verifikojnë fletëvotimet!!!

Procedura e verifikimit është përshkruar në vijim:

- Me ndihmë të numrave serik të fletëvotimeve që janë shtypur në pjesën e fletëvotimit që mbetet në bllokun amë, vërtetoni numrin e fletëvotimeve që keni pranuar me ndihmën e kësaj formule:

Numri serik i fletës së fundit	-	Numri serik i fletës së parë	+ 1 =	Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve
--------------------------------	---	------------------------------	-------	--------------------------------------

Shembull: Nëse numri serik i fletës së parë është 1.501, ndërsa i fletës së fundit 2.035, atëherë keni 535 fletëvotimi ($2.035 - 1.501 + 1 = 535$).

- Krahasoni numrin që e keni fituar me numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar në listën zgjedhore. Duhet të jenë të njëjtë.

Shembull: Nëse në listën zgjedhore ka 535 votues, atëherë duhet të keni 535 fletëvotimi.







- Personat që kanë të drejtë të jenë të pranishëm në pranimin-dorëzimin e materialit zgjedhor janë:
 1. përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave (ata kanë të drejtë të japin vërejtje, të cilat do të regjistrohen në procesverbal (formulari 14))
 2. vëzhgues të akredituar
 3. gazetarët

LLOJET E MATERIALIT ZGJEDHOR

MATERIALE ZGJEDHORE TË BESUESHME	MATERIALE ZGJEDHORE JO TË BESUESHME
1. Blloku amë me fletëvotimet 2. ekstrakti i Listës zgjedhore për vendvotimin; 3. ditari për evidencë të ngjarjeve në vendvotim; 4. Marker-ngjyrë e dukshme për markimin e votuesve 5. Vulë me numrin e vendvotimit dhe 6. Formularët në vijim nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve; • Procesverbal për dorëzimin e materialit zgjedhor nga personi i autorizuar i PDK, këshillit Zgjedhor (në pajtim me rregullat e PDK). Procesverbal për gjendjen e vërtetuar në hapësirën për votim, materiali zgjedhor dhe kutitë e votimit nga Këshilli Zgjedhor (Formulari numër 15) • Procesverbal për votimin, sumimin dhe konfirmimin e rezultateve të vendvotimit (Formulari numër 16gs) • Procesverbal për dorëzimin e procesverbalit për votim dhe materialit tjetër zgjedhor nga Këshilli Zgjedhor, personit të autorizuar të PDK (Formulari numër 22gs)	1. Paravan votimi; 2. Listat e kandidatëve; 3. Kutia e votimit; 4. Shirita plastik sigurimi të numëruar për mbylljen e kutisë së votimit dhe për thesin për transport të materialit të besueshëm; 5. Zarfe të siguruara për paketimin e: • Fletëvotimeve të përdorura (të vlefshme dhe të pavlefshme) • Fletëvotime të papërdorura • Ama e bllokut të fletëvotimeve, lista zgjedhore dhe ditari për evidencë; 6. Një zarf sigurimi rezervë; 7. Një thes i madh i tejdukshëm, me etiketë, për transportim të materialit zgjedhor të besueshëm; 8. Një thes plastik për transportim të materialit zgjedhor jo të besueshëm; 9. Shirita ngjitës për të shënuar thesin për transportim dhe 10. Materiale të tjera jo të besueshëm siç janë: - lapsa kimik - shënues - vizore - gërsërë - jastëk grafiti për lënien e gjurmëve - baxhe për anëtarët e këshillave zgjedhor - doracak për anëtarët e këshillave zgjedhor; - udhëzim për votim - dhe materiale të tjera.

Lista e kandidatëve është në shtojcë dhe së bashku me materialin zgjedhor i dorëzohet Këshillit Zgjedhor.



2. 	3. 	4. 
9. 	10. 	

VENI RE:

- Për vendvotimet të cilët kanë nën 500 votues, Këshillit Zgjedhor i jepet një marker-ngjyrë e dukshme për markim të zgjedhësve.
- Për vendvotimet të cilët kanë mbi 500 votues, Këshillit Zgjedhor i jepen dy marker-ngjyrë e dukshme për markim të zgjedhësve.

ME RËNDËSI:

- Për ruajtje të markerëve-ngjyrë e dukshme për markim të zgjedhësve, obligohet kryetari i KZ-së
- Pas mbarimit të votimit, KZ-ja deri te KKZ, kthen po aq markerë-ngjyre e dukshme për markim të zgjedhësve, sa ka marrë nga KKZ-ja, pa marrë parasysh se në çfarë gjendje janë ato.

PËRGATITJE PARA FILLIMIT TË VOTIMIT

ARRITJE NË VENDVOTIM

Secili anëtar i KZ-së duhet të mbërrijë në vendvotim më së voni në ora 06.00, sipas kohës lokale të vendit përkatës. Nëse ndonjë nga anëtarët mungon, kryetari i KZ-së duhet ta njoftojë KSHZ-në.



PËRGATITJE TË FUNDIT PARA FILLIMIT TË VOTIMIT

Kryetari i KZ-së duhet të sigurohet se të gjithë anëtarët i kanë kuptuar detyrat e tyre.

Kryetari i KZ-së duhet të sigurohet se vendvotimi është rregulluar në mënyrë që votuesit të mund të lëvizin lirisht. Renditja e tavolinave, bankave, paravanët votuese dhe drejtimi i lëvizjes së votuesve, duhet të planifikohet një ditë përpara. Duhet të jenë vendosur të gjitha shenjat. Nëse kjo nuk është bërë sepse ambienti nuk ka qene i hapur një ditë përpara, rregullimi i vendvotimit duhet të bëhet në mëngjes, ditën e zgjedhjeve, por në mënyrë që të mundësohet që votimi të fillojë në ora 07.00.

PARA SE TË VOTOJË VOTUESI I PARË

Para se të fillojë votimi, duhet të ndërmerren këto hapa:

- Kryetari i KZ-së të gjithë anëtarëve të KZ-së dhe përfaqësuesve të autorizuar të listave të kandidatëve të pranishëm, vëzhguesve dhe gazetarëve ua tregon kutinë boshe të votimit dhe numrat në dy shiritat sigurues plastik të numëruar të cilët shënohen në Ditar.
- Në shirit ngjitës shënon numrin e vendvotimit dhe shiritin ngjitës e ngjet në njërën anë të kutisë.
- Mbyllet kutia e votimit (futen dy shiritat plastike të sigurisë në vrimat anësore në kapakun e kutisë, dhe shtrëngohen fortë)
- Numrat e shiritave sigurues plastik regjistrohen në Ditarin e evidencës të ngjarjeve.

Vendvotimi hapet në ora 07:00, sipas kohës lokale të vendit ku zbatohet votimi. Koha e hapjes së vendvotimit regjistrohet në Procesverbalin (Formulari numër 16gs), si dhe në Ditarin për evidentimin e ngjarjeve.

PERSONAT QË MUND TË JENË TË PRANISHËM NË VENDVOTIM

Personat të cilët në ditën e zgjedhjeve mund të jenë të pranishëm në vendvotim janë:

- Votuesit
- Anëtarët/zëvendësit e KZ-së,
- Personi i autorizuar i PDK-së
- Personat që kanë të drejtë të vëzhgojnë punën e KZ-së:
 1. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave të kandidatëve
 2. Vëzhguesit e akredituar dhe
 3. Gazetarët e akredituar të huaj dhe vendor

Votuesit në vendvotim në mënyrë të drejtpërdrejt realizojnë të drejtën e tyre zgjedhore. Ata nuk duhet të qëndrojnë në vendvotim më gjatë sesa nevojitet për të votuar.

Personat që kanë të drejtë të vëzhgojnë punën e KZ-së, duhet të jenë të mirëpritur sepse pikërisht janë ata që e vlerësojnë transparencën dhe legjitimitetin e zgjedhjeve. Nga ana tjetër, ata kanë për detyrë të respektojnë fshehtësinë e votimit dhe mos të pengojnë punën e KZ-së. Nëse ndonjë përfaqësues i autorizuar ose gazetar pengon punën e KZ-së, KZ-ja ka të drejtë të kërkojë nga ky person të largohet nga vendvotimi.



Nëse personi nuk e bënë këtë vullnetarisht, KZ-ja duhet të njoftojë personin e autorizuar të PDK-së, i cili ka të drejtë ta thërras policinë. Çdo largim të ndonjë personi nga vendvotimi, KZ-ja e regjistron në Ditarin për evidencën e ngjarjeve.

KZ-ja përmes kontrollit të autorizimeve dhe/ose dokumenteve personale të identifikimit, duhet të legjitimojë të gjithë personat që vëzhgojnë punën e KZ-së.

PËRFAQËSUES TË AUTORIZUAR TË PARASHTRUESVE TË LISTAVE TË KANDIDATËVE

Përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve, legjitimohen para KZ-së duke treguar:

- Bexhin me numrin e vendvotimit për të cilin është i autorizuar të kryej vëzhgimin që i është dhënë nga KSHZ-ja
- Dokument identifikimi

Në rast se KZ-ja nuk ka lejuar ose nuk ka regjistruar vërejtjet e tyre në Procesverbal (formulari numër 16gs), përfaqësuesit e autorizuar kanë të drejtë që këto vërejtje t'i dorëzojnë në KSHZ, në një afat prej 5 orësh pas firmosjes së Procesverbalit (Formulari numër 16gs).

Përfaqësuesit e autorizuar nuk guxojnë të përdorin ekstrakt të listës zgjedhore për të kontrolluar votuesit.

Përfaqësuesit e autorizuar e kanë të ndaluar të mbajnë simbole partiake në vendvotim.

VËZHgues TË AKREDITUAR

Vëzhguesit e akredituar legjitimohen me bexh të vëzhguesit që e lëshon KSHZ-ja, ndërsa ata janë të detyruar t'i mbajnë me vete.

Vërejtjet e vëzhguesve të akredituar regjistrohen në Ditarin e vendvotimit.

GAZETARË

GAZETARËT e vendit para KZ-së legjitimohen me:

- Akreditim të lëshuar nga mediumi i tij ose nga Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë së bashku (SHGM) ose Asociacioni i gazetarëve të Maqedonisë (AGM) bashkë me
- Dokument identifikimi

Gazetarët E HUAJ legjitimohen me akreditim të lëshuar nga KSHZ-ja.



VOTIMI

KOHËZGJATJA E VOTIMIT

Votimi fillon në ora 07:00 dhe zgjat deri në ora 19:00.

KZ-ja mundet të mbyll vendvotimin para orës 19:00, nëse të gjithë zgjedhësit e regjistruar në listën zgjedhore kanë votuar dhe për këtë kërkohet pajtim nga KSHZ, por numërimi i votave nuk fillon para orës 19:00!

E DREJTA E VOTIMIT

TË DREJTËN E VOTIMIT E ka çdo person i cili: • Është i regjistruar në Ekstraktin e listës zgjedhore dhe • Posedon dokument valid për identifikim personal – letërnjoftimi ose pasaportë të dhënë nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë.	NUK MUND TË VOTOJË PERSON i cili: • Nuk gjendet në Ekstraktin e listës zgjedhore; • Nuk ka dokument përkatës identifikimi; • Në gishtin e madh të djathtë ka gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve; • Refuzon të firmos në Ekstraktin e listës zgjedhore; • Nuk lejon të bëhet markimi me ngjyrë të dukshme për markim të votuesve.
--	---

Procedura për anëtarët e KZ-së në të gjitha këto raste është përshkruar në mënyrë të detajuar në detyrat e të gjithë anëtarëve të KZ-së, të cilat janë shpjeguar më poshtë.

GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE PËR DALJEN E VOTUESVE

KZ-ja, grumbullon të dhënat për daljen e votuesve në votim. Bën llogaritjen dhe si të tilla me anë të postës elektronike i dorëzon në Komisionin shtetëror të Zgjedhjeve (izbori@sec.mk). Zakonisht, kjo bëhet tri herë në ditë.

Zakonisht, kjo bëhet tri herë në ditë në përputhje me dallimin kohor në vendin ku realizohen zgjedhjet, dhe atë:

- Në ora 10:00,
- Në ora 13:00; dhe
- Në ora 17:00

Para kohës së caktuar, kryetari i KZ-së:

- Duhet të përgatisë evidencë për atë se sa votues kanë votuar në vendvotim. Këtë të dhënë do t'i jap anëtari i KZ-së, i cili është përgjegjës për listën zgjedhore, pasi t'i numërojë nënshkrimet dhe gjurmët e gishtit;


Në njoftim shënohet emri i PDK-së, përkatësisht zyrës konsullore ku kryhet votimi, numri i votuesve të regjistruar dhe numri i votuesve të cilët kanë votuar deri në kohën përkatëse.



PROCEDURA E VOTIMIT

Votimi kryhet personalisht, ashtu që zgjedhësit të shkojnë në vendvotim dhe një nga një votojnë.

Procesin e votimit mund ta ndajmë në disa faza, të treguara me fotot e shfaqura, në këtë renditje:



HAPI 1: Anëtari i Këshillit Zgjedhor, pasi votuesi të hyn në vendvotim, e kontrollon nëse ka gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve në gishtin e madh të dorës së djathtë.



HAPI 2: Nëse nga hapi i kaluar verifikohet se gishti i zgjedhësit nuk ka gjurmë të ngjyrës së dukshme për markim të e votuesve – kalohet në konfirmimin e identitetit të tij.

- Zgjedhësit mund të tregojnë identitetin e tyre personal me njërin nga këto dy dokumente:
- LETËRNJOFTIM BIOMETRIK VALID, ose
- PASAPORTË BIOMETRIKE VALIDE lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë.

VENI RE 1: PËR IDENTIFIKIMIN E IDENTITETIT TË ZGJEDHËSIT NUK MUND TË PRANOHET ASNJË DOKUMENT TJETËR (patentë shoferi, librezë shëndetësie, librezë të nxënësve, indeks ose pasaportë të ndonjë shteti tjetër.)





HAPI 3: Pas verifikimit të identitetit të zgjedhësit kontrollohet a gjendet ai në Ekstraktin e listës zgjedhore.

Kur të verifikohet se zgjedhësi gjendet në ekstraktin e Listës zgjedhore:

- Në ekstraktin e Listës zgjedhore para emrit të zgjedhësit e rrethon numrin rendor.
- Zgjedhësit i lejon të nënshkruhet në Listën zgjedhore në grafën pranë emrit të tij.

Nëse zgjedhësi, i cili gjendet në Listën zgjedhor është analfabet ose ka të meta fizike, shtyp gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë në grafën e rezervuar për nënshkrim. Për këtë rast, përdoret mbështetës grafiti për gjurmë. Në rast se zgjedhësi nuk ka gisht të madh në dorën e djathtë, gjurmët do t'i shtypen në gishtin e madh të dorës së majtë. Në rast se zgjedhësi nuk gisht të madh në dorën djathtë as në dorën e majtë, nuk i merren gjurmët. Ky rast evidentohet në Ditarin e evidencës së ngjarjeve.



HAPI 4: Pas nënshkrimit të zgjedhësit në Ekstraktin e listës zgjedhore, anëtari i Këshillit Zgjedhor i cili jep fletëvotimet, kryen disa veprime sipas kësaj renditjeje:

- Nga blloqet amë shkëput një fletëvotim për një votues
- (KENI KUJDES: Numri serik mbetet në bllokun amë !!!)
- E vulos fletëvotimin në vendin përkatës, në anën e përparme me numrin e vendvotimit.
- Votuesit i jep fletëvotim.
- Votuesit i shpjegon teknikën e votimit.



HAPI 5: Pasi që zgjedhësit t'i jepet në gishtin e madh të dorës së djathtë të tij, i vendoset gjurmë nga ngjyra e dukshme për markim të votuesve.

Nëse zgjedhësi nuk ka gishtin e madh në dorën djathtë, gjurmimi bëhet në gishtin e madh të dorës së majtë. Nëse nuk ka gisht të madh as në dorën e majtë, nuk kryhet markimi.

Për ta bërë markimin në mënyrë të drejtë të gishtit të madh të dorës së djathtë me ngjyrë, lyeni mbi thoin e gishtit të madh të dorës së djathtë. Sigurohuni që ngjyra është lyer mbi thoin dhe mbi pjesë të lëkurës.





HAPI 6: Zgjedhësi drejtohet për të votuar kah paravani zgjedhor

SECILI VOTUES PAS PARAVANIT
ZGJEDHOR VOTON I VETËM!

NJË VOTUES = NJË VOTË!



HAPI 7: Zgjedhësi fletëvotimin e palosur e lëshon në kutinë e votimit.

Anëtari i Këshillit Zgjedhor që shërben me marker-ngjyrë të dukshme për markim të votuesve duhet të sigurohet se:

1. Zgjedhësi e ka palosur fletëvotimin;
2. Zgjedhësi fletëvotimin e palosur e ka lëshuar në kutinë e votimi.

Anëtari i KZ-së i cili shërben me ekstraktin e listës zgjedhore, votuesit pas mbarimit të votimit, ia kthen dokumentin e identifikimit personal.



Dokumenti i identifikimit personal i kthehet votuesit, atëherë kur ai mbaron me votimin.



ANKESA NGA ZGJEDHËSIT

Nëse ndonjë zgjedhës dëshiron të paraqes ankesë për mbrojtje të së drejtës të tij zgjedhore të cilën mendon se i është shkelur, Këshilli Zgjedhor:

- Do ta udhëzojë të paraqitet në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, ose në internet faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (www.sec.mk), ku ka formular për të paraqitur ankesë.

VOTIMI I PERSONAVE QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË

- Zgjedhësi me të meta fizike ose analfabet, i cili për këtë shkak nuk mund të votojë në mënyrën e përcaktuar me Kodin zgjedhor, ka të drejtë me vete të marrë një person i cili do t'i ndihmojë gjatë votimit.
- Nëse zgjedhësi nuk sjell me vete person i cili do t'i ndihmojë gjatë votimit, atëherë KZ-ja do të caktojë një person tjetër nga radhët e zgjedhësve të pranishëm në vendvotim. Domethënë, ky person në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë anëtar i Këshillit Zgjedhor, përfaqësues i autorizuar të paraqitësve të listave ose vëzhgues.
- Para se të votojë, KZ-ja personin që do të jap ndihmën do ta njoftojë se në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikojë mbi vendimin e zgjedhësit.
- Zgjedhësi dhe personi i cili e ndihmon, së bashku shkojnë drejtë paravanit për votim. (Votimi edhe në këtë rast, detyrimisht zhvillohet pas paravanit).

VËREJTJE:

Plotësimi i fletëvotimit bëhet ashtu që, personi që ndihmon e pyet votuesin për cilën listë dëshiron të votojë, ia tregon votuesit numrin rendor para listës së kandidatëve për të cilën votuesi dëshiron të votojë dhe votuesi vetë e rrethon fletëvotimin. Personi që ndihmon mund të plotësojë fletëvotimin në vend të votuesit vetëm në rast se votuesi është i verbër ose me të meta fizike, për shkak të cilës nuk mund të plotësojë vet fletëvotimin.


- Votimin e këtillë, Këshilli Zgjedhor e shënon në procesverbal, (formulari numër 16 gs), dhe në Ditarin për evidentimin e ngjarjeve, ku shënohen të dhënat nga letërnjoftimi i personit që ka ndihmuar dhe në këtë shënim nënshkruhen të gjithë anëtarët e KZ-së.

VËREJTJE:

Një person i njëjtë mund të ndihmojë vetëm dy zgjedhës të cilët kanë nevojë për ndihmë!

MBYLLJE E VENDVOTIMIT

- Vendvotimi mbyllet në ora 19:00., sipas kohës lokale të vendit ku zhvillohet votimi
- Zgjedhësve të cilët në ora 19:00 gjenden në objektin ku zhvillohet votimi, KZ-ja do t'u lejojë të votojnë.
- Në ora 19:00 anëtar i KZ-së, i cili punon me markerin- ngjyrën e dukshme, do të ndalet në fund të radhës ku qëndrojnë zgjedhësit të cilët janë gjetur në objekt.
- Pasi të ketë votuar edhe zgjedhësi i fundit, vetëm personat e autorizuar kanë të drejtë të mbeten në vendvotim.



Personat e autorizuar që mund të mbesin në vendvotim pas mbylljes, janë:

- anëtarët e KZ-së
- përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave
- vëzhguesit e akredituar
- përfaqësuesi i autorizuar i PDK –së

Pasi të largohet zgjedhësi i fundit nga vendvotimi, kryetari i KZ-së:

- mbyll vrimën e kutisë të votimit,
- shënon në Ditarin për evidentim të ngjarjeve kohën kur ka përfunduar votimi, si dhe emrat e personave të autorizuar të pranishëm në vendvotim,
- në Procesverbal numër 16gs, do të shënojë kohën e përfundimit të votimit,
- në Ditarin për evidentimin e ngjarjeve shënon numrat e shiritave të sigurisë, me të cilat është vulosur kutia e votimit,
- do t'i informojë personat e autorizuar të pranishëm në vendvotime nëse largohen nga vendvotimi pasi të fillojë numërimi i votave, se nuk do t'u lejohet të kthehen në vendvotim përsëri.

Nëse votimi ndërpritet më gjatë se 1 orë, ai do të zgjatet për aq kohë sa ka qenë ndërprerja, por jo më shumë se 3 orë. Nëse, për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë në vendvotim, votimi ndërpritet më shumë se 3 orë, votimi në këtë vendvotim nuk do të vazhdojë.



NDËRPRERJE E VOTIMIT

KZ-ja mund të ndërpres votimin në këto raste:

- Nëse në vendvotim prishet rendi, deri në rivendosjen e tij;
- Në rast të motit të keq ose rrethana të tjera të jashtëzakonshme;
- Nëse nuk është siguruar qasja deri në vendvotim nga ana e policisë, ndërsa ka pasur nevojë për këtë;
- Nëse thirret policia dhe ajo nuk i përgjigjet thirrjes.

Ne çdo rast, nëse ka pasur ndërprerje të votimit, arsyet duhet të evidentohen në Procesverbal (Formular numër 16gs).

Nëse:

Atëherë:

Votimi ndërpritet më pak se 1 orë	---->	Votimi nuk vazhdon; përfundon në ora 19.00
Votimi ndërpritet më shumë se 1 orë, dhe më pak se 3 orë	---->	Votimi vazhdon për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja
Votimi është ndërprerë më gjatë se tri orë	---->	Njoftohet KKZ-ja; Votimi atë ditë nuk vazhdon.

VËREJTJE: Rregullat e njëjta aplikohen edhe nëse votimi fillon më vonë se koha e paraparë (më vonë se ora 07:00).

SUMIMI DHE VERIFIKIMI I REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE TË VENDVOTIMIT

Këshilli Zgjedhor, pas mbylljes së vendvotimit vepron në këtë mënyrë:

1. BARAZIMI I FLETËVOTIMEVE

1) KZ-ja, i numëron nënshkrimet dhe gjurmët e gishtërinjve të votuesve në Ekstraktin e listës zgjedhore. Në këtë mënyrë përcaktohet numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar. Ky numër shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16gs);

2) Numërohen fletëvotimet e papërdorura. Numri i tyre verifikohet në këtë mënyrë:

Numri serik i fletëvotimit të fundit të papërdorur	-	Numri serik i fletëvotimit të parë të papërdorur	+ 1 =	Fletëvotime të papërdorura
Shembull:				
35700	-	35500	+ 1 =	201

Ky numër shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16gs).



3) Nga numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të dorëzuara për këtë vendvotim (Formulari numër 16 gs) merret numri i fletëvotimeve të përdorura (formulari numër 16gs). Rezultati i këtij operacioni jep numrin e fletëvotimeve të përdorura në procesin e votimit.

Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pranuar	-	Numri i fletëvotimeve të përdorura	=	Fletëvotime të shfrytëzuara (të përdorura)
Shembull:				
800	-	201	=	599

Numri i fletëvotimeve të përdorura PATJETËR duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar.

Nëse këto numra nuk janë të barabartë, Këshilli Zgjedhor duhet këtë rast ta shënojë në Procesverbal (Formulari numër 16gs, rubrika „kontrollimi i dytë pas mbylljes së vendvotimit“) dhe në Ditar dhe për këtë ta njoftoj Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

4) Fletëvotimeve të përdorura:

- u shkëputet këndi i poshtëm i djathtë,
- vihen në zarf të posaçëm, i cili mbyllet dhe vuloset,
- mbi zarfin ngjitet etiketë në të cilën shënohet numri i vendvotimit, numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të përdorura dhe numri serik i fletëvotimit të parë dhe të fundit.

VENI RE:

Kryetari KZ-së është i detyruar që para hapjes së kutisë së votimit t'i pyet përfaqësuesit e autorizuar të parashtresve të listave të kandidatëve, nëse kanë vërejtje për procedurën e votimit, nëse kanë, të njëjtat shënohen në procesverbalin 16 gs, në pjesën për vërejtje, për procedurën zgjedhore.

2. HAPJA E KUTISË SË VOTIMIT

1) Para hapjes së kutisë të votimit kryetari i KZ-së:

- kontrollon a janë të njëjtë numrat e shiritave sigurues plastik, me të cilët është mbyllur kutia e votimit gjatë hapjes së vendvotimit që janë të shënuar në Ditar, dhe ua tregon të pranishmëve.
- nëse numrat e shiritave përputhen, këtë e shënon në Ditar dhe vazhdon me hapjen e kutisë
- Nëse numrat e shiritave nuk përputhen, këtë rast e shënon në Procesverbal (Formulari numër 16gs), dhe për këtë rast e njofton KOMISIONIN SHETETËROR TË ZGJEDHJEVE dhe vazhdon me procedurën e sumimit dhe konfirmimit të rezultateve.


Para se të hapet kutia e votimit, me short caktohet një nga anëtarët e Komisionit Zgjedhor cili:

- Fletëvotimet një nga një do t'i nxjerrë nga kutia e votimit
- Fletëvotimet e hapura ia dorëzon kryetarit të Këshillit Zgjedhor.

2) Kryetari i Këshillit Zgjedhor, të gjithë të pranishmëve ua tregon fletëvotimin.



3) KZ-ja, përcakton se fletëvotimi a është i vlefshëm, i paplotësuar ose i pavlefshëm dhe për cilin kandidatit është votuar. Për këtë qëllim, në tryezën e punës formohen grumbuj përkatës të fletëvotimeve.



Fletëvotim i paplotësuar



Fletëvotim i pavlefshëm



Fletëvotimi i vlefshëm:

Fletëvotimi është i vlefshëm nëse është në pajtim me nenin 110 të Kodit zgjedhor: „Zgjedhësi votimin e kryen në atë mënyrë, që e rrethon numrin rendor të parashtruesit të listës, përkatësisht numrin rendor para kandidatit për të cilin është përcaktuar të votojë dhe fletëvotimin e palosur e lëshon në kuti të votimit.”

Për fletëvotim të vlefshëm llogaritet edhe ai fletëvotim, i cili në mënyrë të sigurt dhe pa hamendje mund të konstatohet për cilën listë të kandidatëve ka votuar zgjedhësi

Gjatë verifikimit çka nënkupton „mënyrë të sigurt dhe pa hamendje,“? . Duhet nisur nga ajo sesi është plotësuar fletëvotimi, përkatësisht nëse zgjedhësi në mënyrë të qartë ka shprehur dëshirën, ka votuar vetëm për një kandidat.

Mënyrë e sigurt dhe pahamendje e shprehjes së dëshirës të zgjedhësit mund të paraqesë edhe fletëvotimi, në të cilën zgjedhësi në vend të numrit rendor para parashtruesit të listës, ka rrethuar emrin dhe mbiemrin e kandidatit ose simbolin e parashtruesit të listës apo në një mënyrë tjetër përkatëse është përcaktuar për parashtruesin e listës, nëse shënimi është në suazat e një liste të kandidatit.


Fletëvotimi është i pavlefshëm:

- nëse ka të rrethuara më shumë lista të kandidatit
- nëse është e shlyer pjesërisht ose tërësisht,
- nëse vula në fletëvotim nuk është përkatëse me numrin e vendvotimit ku është votuar
- nëse në anën e përparme nuk ka vulë
- nëse është e rrethuar, përkatësisht e plotësuar me flomaster me çfarëdo ngjyre
- nëse është e rrethuar, përkatësisht e plotësuar me stilolaps me çfarëdo ngjyre, përveç ngjyrë të kaltër
- nëse është i paplotësuar

4) Procedura përsëritet derisa të gjithë fletëvotimet të nxirren nga kutia e votimit.

5) KZ-ja, gjithë fletëvotimet e PA
PLOTËSUARA

- I shlyen në tërë gjatësinë, dhe
- I vendosë në grumbull me fletëvotimet e pavlefshme.



6) të gjitha fletëvotimet e PAVLEFSHME vihen në zarf të posaçëm, në të cilin shkruhet „fletëvotime të pavlefshme”.

Nëse ndonjëri nga përfaqësuesit e autorizuar ose anëtar i Këshillit Zgjedhor gojarisht kundërshton për ndonjë fletëvotim të pavlefshëm, Këshilli Zgjedhor vendos me anë të votimit dhe rasti shënohet në Procesverbal (Formulari numër 16gs).



VERIFIKIMI I VOTAVE TË FITUARA SIPAS LISTËS SË KANDIDATIT

- fletëvotimet nxirren një nga një dhe konstatohet për cilën listë është votuar
- vota e dhënë regjistrohet në letër të thjeshtë
- fletëvotimet e secilit grumbull edhe njëherë numërohen
- rezultatet shënohen në Procesverbal (Formular numër 16gs).

KENI KUJDES NË SIGURINË E FLETËVOTIMEVE TË NUMËRUARA

PLOTËSIMI I PROCESVERBALIT

KZ-ja përpilon procesverbalin e votimit, sumimit dhe verifikimit të rezultateve në Procesverbalin e veçantë:

- Formulari numër 16gs, për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës së Maqedonisë.

Këtë formular e pranoni bashkë me materialin e besueshëm zgjedhor, të përcaktuar dhe të vulosur me vulë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Formularët bashkë me udhëzimet e plotësimeve të tyre, i gjeni në internet- faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve www.sec.mk PARA SE TË FILLONI ME PLOTËSIMIN E PROCESVERBALIT LEXONI ME KUJDES UDHËZIMET.

KZ-ja, pranon VETËM NJË EKZEMPLAR të formularit origjinal numër 16gs me vulë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. T'i ruani me kujdes!

Procesverbalin:

- e plotëson kryetari i KZ-së,
- e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e KZ-së
- dorëzohet në KOMISIONIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE.

Për plotësimin e procesverbalit:

Këshilli Zgjedhor në rast të GABIMEVE GJATË PLOTËSIMIT TË PROCESVERBALIT:

- 1) me stilolaps e shlyen fjalën, përkatësisht numrin e gabuar, që edhe më tej të mbetet i lexueshëm,
- 2) me stilolaps plotëson të dhënë e saktë,
- 3) përskaaj përmirësimin nënshkruhet kryetari i KZ-së dhe vihet vula e Këshillit Zgjedhor.

Shembull

~~55~~

57

XXX

Numri i gabuar

E dhëna e saktë

Vula dhe nënshkrimi i kryetarit
të Këshillit Zgjedhor



PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

Materiali zgjedhor paketohet në këtë mënyrë:

1) Në thes plastik të tejdukshëm për transportimin e materiali zgjedhor të besueshëm, në të cilin vihet etiketë ngjytëse me emrin e PDK-së, lloji i zgjedhjeve dhe numri i vendvotimit, paketohen:

1.1. Zarfi i mbyllur ku më parë janë të vendosura fletëvotimet e përdorura(të vlefshme dhe të pavlefshme);

1.2. Zarfi i mbyllur me fletëvotime të papërdorura dhe blloku amë (koçani) me fletëvotime të përdorura;

1.3. Zarfi i mbyllur me ekstraktin e Listës zgjedhore dhe Ditarin e evidencës së ngjarjeve.



Fletëvotime të përdorura



Fletëvotime të papërdorura



Lista zgjedhore

+

+

Bloku amë (koçani) me
fletëvotime të përdorura

Ditari i evidencës së ngjarjeve






- 2) Në thesin plastik të tejdukshëm në të cilin nuk ka etiketë ngjitëse pakëtohet materiali jo i besueshëm zgjedhor.

materiali jo i besueshëm

----->



- 3) PROCESVERBALI ORIGINAL për sumimin e rezultateve (Formulari numër 16gs) , Procesverbalin për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari numër 22gs), vula me numrin e vendvotimit dhe markeri-ngjyrë e dukshme për markim të votuesve nuk pakëtohen në thesin me material zgjedhor.
- 4) Në thesin tjetër plastik të tejdukshëm në të cilin nuk ka etiketë ngjitëse, pakëtohet materiali tjetër jo i besueshëm.
- 5) Procesverbali origjinal për sumimin e rezultateve (formulari numër 16 gs) dhe procesverbali për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari numër 22 gs), në zarf të posaçëm i dorëzohen personit të autorizuar të PDK-së.
- 6) Për pranim-dorëzim të materialit zgjedhor, përpilohet procesverbal (Formulari numër 22 gs)



- 7) Markerët-ngjyrë e dukshme për markim të votuesve dhe vula me numër të vendvotimit i jepen në dorë personit të autorizuar të PDK-së.
- Materiali zgjedhor i votimit në Komisionin shtetëror të Zgjedhjeve dorëzohet nëpërmjet postës diplomatike.



NDALËSAT NË VENDVOTIM

NDALIMI I PËRDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR DHE FOTOAPARATIT PËR FOTOGRAFIMIN E FLETËVOTIMIT

Ndalohet përdorimi i telefonit celular ose fotoaparatit për fotografimin e fletëvotimit.

Përfaqësuesit e autorizuar të listave, vëzhguesit dhe votuesit, në ditën e zgjedhjeve në vendvotim, nuk guxojnë të përdorin telefon celular, fotoaparate dhe mjete tjera për fotografimin e fletëvotimit.

Këshilli Zgjedhor, ka të drejtë ta largojë secilin person nga vendvotimi, nëse nuk i përmbahet këtij ndalimi.



NDALIM PËR MBAJTJEN E ARMËS NË VENDVOTIM

Përveç policisë, askush nuk guxon të vjen i armatosur në vendvotim. Policia në vendvotim, mund të hyjë vetëm në raste kur thirret nga Këshilli Zgjedhor dhe kur vërehet prishje e rendit dhe qetësisë.



NDALIMI I VOTIMIT FAMILJAR, GRUPOR DHE NË EMËR TË TJETRIT

E drejta e fshehtësisë së votës garantohej me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Këshillat Zgjedhor, janë ata të cilët kanë përgjegjësi t'i njohin dhe t'i pengojnë përpjekjet eventuale për cenimin e fshehtësisë së votimit.

KËSHILLI ZGJEDHOR GJATË KOHËS SË VOTIMIT,
VOTUESIT DUHET T'I SIGUROJË QË TË JETË I VETËM PAS PARAVANIT ZGJEDHOR!

Në Republikën e Maqedonisë, votimi familjar, grupor dhe në emër të tjetrit, janë të ndaluar. Kjo paraqet cenim të drejtës zgjedhore, bazë për cenimin e fshehtësisë së votës dhe mund të çojë deri në prishjen e zgjedhjeve. Me votimin familjar cenohet fshehtësia e votës, barazia e të drejtës zgjedhore dhe përcaktimi i lirë i votimit.



Ndalimi i votimit familjar, grupor dhe votimit në emër të tjetrit i përket:

- NDALIMIT një person të votojë për tjetrin/për tjerë (votimi në emër të tjetrit);
- NDALIMIT një anëtar i familjes anëtarëve tjerë pas paravanit zgjedhor t'u tregojë si dhe për cilin të votojnë (votim familjar);
- NDALIMI dy vetë, grup ose gjithë familja të votojnë pas paravanit zgjedhor (votim grupor) etj.



KZ-ja, është i detyruar të sigurojë që gjatë kohës së votimit, votuesi të jetë i vetëm pas paravanit zgjedhor!

Anëtarët e Këshillit Zgjedhor DUHET këto dukuri t'i hetojnë dhe t'i PENGJOJNË.

Anëtarët e Këshillit Zgjedhor, në rast të tentimit të votimit familjar, janë të detyruar:

1. Ta pengojnë tentimin dhe
2. Çdo tentim ta evidentojnë në Ditarin e evidencës së ngjarjeve

Kundër anëtarit të Këshillit Zgjedhor, i cili ka mundësuar (nuk ka penguar) votim familjar do të ngrihet:

- procedurë disiplinore (sanksion-ndërprerje marrëdhënie pune)
- padi kundërvajtjeje (sanksion-gjobë prej 500 deri 1.500 ero)
- padi penale (sanksion – dënim me burg së paku 5 vjet)

Kundër personit i cili merr pjesë në votim familjar:

- të parashtrohet padi kundërvajtjeje
- të parashtrohet padi penale

Kodi zgjedhor, votimin familjar e parasheh si bazë për prishjen e votimit në vendvotim.



DALLIMI MIDIS VOTIMIT FAMILJAR DHE NË GRUP, SI DHE VOTIMIT PËR PERSON TJETËR DHE VOTIMIT TË PERSONAVE QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË

Duhet bërë dallimi midis votimit familjar, votimit në grup, votimit për një person tjetër dhe votimit të personave që nuk mund të votojnë vetë (Shih kapitullin: Votimi i personave që kanë nevojë për ndihmë).

Jo gjithmonë, kur ka dy votues pas paravanit për votim, bëhet fjalë për votim familjar ose në grup. ME PËRJASHTIM, një zgjedhës i cili ka të meta fizike ose është analfabet dhe për këtë arsye nuk mund të votojë, ashtu siç është paraparë me Kodin zgjedhor, ka të drejtë me vete të sjell një person i cili do t'i ndihmojë të votojë. Në atë rast, të dy (votuesi dhe personi që e ndihmon) së bashku drejtohen drejt paravanit për votim. Megjithatë, personi i cili jep ndihmë vetëm e ndihmon votuesin të SHPREH VULLNETIN e tij; me ndihmën e tij ai NUK NDIKON MBI VENDIMIN e zgjedhësit.

Por, asnjëherë nuk duhet harruar rregullën:

GJATË VOTIMIT KËSHILLI ZGJEDHOR DUHET T'I MUNDËSOJË VOTUESIT TË QËNDROJË VETË PAS PARAVANIT PËR VOTIM!

BASHKËPUNIMI ME POLICINË NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Objektin ku është vendosur vendvotimi, e sigurojnë përfaqësuesit e policisë të vendit nikoqir. Kryetari i KZ-së, nëse ka nevojë për thirrjen e policisë, e njofton personin e autorizuar të PDK-së. Vetëm personi i autorizuar i PDK-së mund të komunikojë me përfaqësuesit e policisë të shtetit nikoqir.

Nevoja për të thirrur policinë përcaktohet në formular të veçantë

Këshilli Zgjedhor mund ta thërret policinë në lokalin ku votohet, në qoftë se:

- Prishet rendi dhe qetësia në vendvotim-deri sa të rivendoset rendi dhe qetësia
- Largim të personave të pranishëm të paautorizuar nga objekti dhe vendi ku kryhet votimi.
- Pas mbylljes së vendvotimit, bëhet largimi i të gjithë personave të paautorizuar nga objekti ku është i vendosur vendvotimi.

